



Prishtinë, 24 qershor 2014
Kodi i ZRRE-së: V_636_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 7 të Ligjit për Energjinë,
- Dispozitat e nenit 6 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
- Kërkesën e KEDS të datës 29.05.2014 për aprovimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2014 – 2023”,

në seancën e mbajtur me datë 24 qershor 2014, nxori këtë:

VENDIM

I **Aprovohet** dokumenti “**Plani Zhvillimor i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2014 – 2023**”

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 29.05.2014 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit “Plani Zhvillimor i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2014 – 2023” nga furnizuesi publik KEDS. Dokumenti ka kaluar në shumë faza të zhvillimit, dhe fillimisht është zhvilluar si plan zhvillimor pesë (5) vjeçar, por me insistimin e ZRRE-së gjatë procesit të komentimit të dokumentit, e që ishte i bazuar në kërkesat ligjore, në fund dokumenti është zhvilluar për afat dhjetë (10) vjeçar. Pas komentimeve dhe analizimit të projekteve të paraqitura, dhe pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së nga KEDS, ZRRE **aprovon** dokumentin “**Plani Zhvillimor i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2014 – 2023**” si në shtojcë të këtij vendimi.

Nga data e pranimit të këtij vendimi apo publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, KEDS do të publikojë në faqen e vet elektronike versionin e aprovuar të “Planit Zhvillimor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2014 – 2023”.

- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Plani Zhvillimor i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2014 – 2023



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar